

**20160531333**

## **LIGJ PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË LIGJIT PËR VEPRIMTARI TURISTIKE**

### Neni 1

Në Ligjin për veprimtari turistike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 62/2004, 89/2008, 12/2009, 17/11, 47/11, 53/11, 123/12, 164/13, 27/14, 116/15 dhe 192/15) në nenin 26 paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

“Personi fizik nga organi i administratës shtetërore për punët nga sfera e turizmit, që e mban procedurën, me detyrë zyrtare i grumbullon dëshmitë nga paragrafi 2 pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, nga organi kompetent publik, në afat prej tri ditësh pune nga parashtrimi i kërkesës.“.

Pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 4, si vijon:

“Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik është i detyruar dëshmitë e kërkuara nga paragrafi 3 i këtij neni t’i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.“.

Në paragrafin 4 që bëhet paragraf 5 fjalët: “ministri që udhëheq” shlyhet.

Në paragrafin 5 që bëhet paragraf 6 fjalët: “ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore për punët nga sfera e turizmit” zëvendësohen me fjalët: “Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë.”

### Neni 2

Neni 27-a shlyhet.

### Neni 3

Në nenin 66-a pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 4 si vijon:

Për kundërvajtjet e përcaktuara në paragrafët 71-v i këtij neni, procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”

### Neni 4

Pas nenit 71-b shtohet nen i ri 71-v si vijon:

#### “Neni 71-v

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar nga organi kompetent shtetëror për punët nga sfera e hotelerisë, nëse nuk i kërkon dëshmitë me detyrë zyrtare në afat të përcaktuar në nenin 26 paragrafin 3 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik nga i cili janë kërkuar dëshmitë nëse nuk i dorëzon dëshmitë e kërkuara në afat të përcaktuar në nenin 26 paragrafin 4 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar nga organi kompetent shtetëror për punët nga sfera e hotelerisë, nëse nuk vendose për kërkesën në afatin e përcaktuar në nenin 27 paragrafin 1 të këtij ligji.

### Neni 5

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të mbarojnë në pajtim me ligjin me të cilin kanë filluar.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa do të fillojë të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në pajtim me nenin 141 nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 124/15).